

URDHËR
Nr. 183, datë 26.3.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 633, DATË 17.11.2020, “PËR NDALIMIN
E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga *COVID-19*, si edhe të vendimit të Komitetit Teknik nr. 1594, datë 26.3.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi “deri në datën 25.3.2021” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në datën 8.4.2021”.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**